

Sot, e dielë, 15 Janarë 2017, është një ditë tejet e veçantë në historinë e Sllovenisë. Pikërisht 25 vite më parë, Sllovenia u njoh ndërkombëtarisht dhe fiksoi përgjithmonë pozitën e saj në hartën botërore. Ka qenë një kohë emocionuese që ndjehet akoma dhe kujtimi për të është ende i gjallë.

Ai vit si i tillë ishte i veçantë edhe për tjetër gjë – ndër të tjera sepse Sllovenia dhe Maqedonia vendosën marrëdhënie reciproke diplomatike. Sllovenia ishte atëherë shteti i parë që hapi ambasadën e saj në Shkup, ndërsa ambasada e parë e Maqedonisë u hap pikërisht në Ljubljana. Këto fakte tashmë janë pjesë e historisë diplomatike, megjithatë mbeten me ne në jetën e përditshme.

Shënuam të dy përvjetorët, dy njëzet e pesëvjet jubiletë, të premtën e kaluar, më 13 Janarë, me hapjen e ekspozitës fotografike të lipicanëve në Galerinë e NLB-së në qendrën e qytetit. Lipicanët janë racë e veçantë e kuajve të rritur tashmë për më shumë se gjysmë mijëvjeçari në vendin Lipica të Slloveninë jugperëndimore, nga duar të kujdesshme dhe të afta sllovene e të lidhura ngushtë me natyrën. Autor i ekspozitës është fotografia me famë botërore, znj. Alenka Slavinec, krijuese dhe artist i komunikimit vizual.

Ky ishte evenimenti i parë në seri të njëzet e pesëve me të cilat do të shënojmë dy përvjetorët në mbarë vendin. Me një numër të evenimenteve diplomatike, ekonomike dhe kulturore në mbarë vendin do të pasqyrojmë dhe ilustrojmë gamën e gjerë diplomatike mes shteteve dhe qytetarëve të tyre.

Të inspiruar nga e kaluara hapërojmë kah e ardhmja.

Ju ftojme përzemërsisht që të na bashkangjiteni!

Prof. Dr. Milan Jazbec
Ambasador